



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 03.02.2017

**Vendim**  
**Nr. 20, datë 03.02.2017**

**PËR MIRATIMIN E DISA PROÇEDURAVE TË REJA NË  
RREGULLOREN E ESSE 3**

Në mbështetje të nenit **38** të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 03.02.2017,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë procedurat e mëposhtme në Rregulloren e ESSE3 në lidhje me kurrikulat dhe studentët:
  - Kurrikula e studimit do të hidhet në fillim të vitit akademik, ku në vitin aktual, p.sh. 2016, ajo do të ketë lëndët e vitit të parë, kursi 1, brezi 2016; lëndët e vitit të dytë, kursi 2, brezi 2015 dhe lëndët e vitit të tretë, kursi 3, brezi 2014.
  - Shpërndarja e lëndëve në vite do të kryhet për të tre brezat, p.sh. brezi 2014, KS 2016 (kursi 3); brezi 2015, KS 2016 (kursi 2); brezi 2016, KS 2016 (KS1).
  - Studentët pas regjistrimit në sistem do të ndahen në grupe statike. Çdo student i bashkëngjitet plani mësimor i miratuar për brezin e tij me të cilin përfundon studimit. (Studenti i përshtatet kurrikulës së re, nëse tejkalon studimet e tij më tepër se 3 vjet të kohëzgjatjes normale të studimeve për programet "Bachelor" dhe 2 vjet për programet "Master").
  - Çdo lëndë është në grupin mësimor të caktuar gjatë regjistrimit të studentit (P.sh., nëse student i është në grupin 2, të gjitha lëndët i ndjek me grupin 2, por në lëndët me zgjedhje mund të zgjedhë edhe grupe të tjera).
  - Çdo lëndë në kurrikul lidhet me pedagogun përkatës, ku specifikohet cili është seminaristi, lektori dhe titullari i lëndës për secilin grup mësimor.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

---

- Për zhvillimin e provimeve krijohen datat e provimeve dhe komisionet e tyre sipas grupeve mësimore ose të gjitha grupet në një procesverbal siç e vendos universiteti. Regjistrimi i studentëve në provime në sezon të rregullt kryhet nga sekretaria, ndërsa në sezon riprovimesh nga *web* faqja e studentit.
  - Pedagogu nga faqja e tij vendos vlerësimin gjatë vitit dhe notën e provimit përfundimtar, gjeneron procesverbalin, të cilin e dorëzon në sekretari në një afat kohor të përcaktuar nga universiteti. Sekretaria e arkivon procesverbalin, duke bllokuar modifikimin e tij.
  - Tarifimi i studentëve kryhet në fillim të vitit akademik, ku studenti me mandat arkëtimin e gjeneruar nga sistemi, kryen pagesën në bankë.
  - Në fund të vitit akademik kryhet proçesi i kalueshmërisë së studentëve në vitin pasardhës. Studentët që nuk përmbushin kufirin e krediteve të përcaktuara nga universiteti emërohen përsëritës.
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.